



*Organizata Bamirëse e Inkorporuar 1158228  
Përshatur nga zyra e Komisionerit të Shërbimeve të  
Emigracionit (Nr. N201700019)*

*Konsortium bamirësie nr.  
1105502*

# Si të aplikosh për azil

Versioni shqip

Përditësimi i fundit: Nëntor 2022

## Mbi Rainbow Migration

Ne mbështesim lezbiket, gejt, biseksualët, transgjitorët, queer dhe interseksualët (LGBTQI+) në sistemin e azilit dhe emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar.

---

*Mund të na kontaktoni në [hello@rainbowmigration.org.uk](mailto:hello@rainbowmigration.org.uk)  
ose në 020 7922 7812*

---

Mbrojtja që i jepet një refugjati të njohur quhet 'azil' dhe do të thotë që Mbretëria e Bashkuar nuk do t'ju kthejë përsëri në vendlindjen tuaj. Ju do të duhet të bindni Home Office (Ministrinë e Brendshme) ose një gjykatës se do të rrezikonit nga dëmtimi serioz në vendlindjen tuaj për faktin se jeni lezbike, gej, biseksual, transgjitorë, homoseksual ose interseksual (LGBTQI +).

## **Përmbajtja**

Fillimi i aplikimit tuaj.....	2
Intervista e shqyrtimit.....	3
Intervista e azilit.....	4
Prova.....	6
Deklarata juaj personale.....	6
Deklaratat e dëshmitarit ose letrat e mbështetjes.....	6
Raportet mjekësore.....	7
Informacion për shtetin.....	7
Rezultatet e mundshme.....	7
Rezultati 1: jepet statusi i refugjatit për 5 vite.....	7
Rezultati 2: jepet mbrojtje humanitare për 5 vite.....	8
Rezultati 3: jepet një leje tjetër qëndrimi.....	8
Rezultati 4: refuzohet – me të drejtë apelimi në MB.....	8
Rezultati 5: refuzohet – pa të drejtë apelimi deri pas largimit nga MB.....	8
Rezultati 6: refuzohet – pa të drejtë apelimi.....	8
Apelimet.....	9
Konfidencialiteti në apeline.....	9
Rezultatet e apelimit.....	10
Rezultati 1: apelimi pranohet.....	10
Rezultati 2: apelimi refuzohet.....	11
Aplikimi për leje për apelim në Gjykatën e Lartë.....	11
Seanca dëgjimore në Gjykatën e Lartë.....	11
Kërkesë e re.....	12
Gjetja e një avokati.....	12
Më shumë informacion.....	13

## Fillimi i aplikimit tuaj

Home Office pret që njerëzit që kanë me të vërtetë nevojë për mbrojtje do të kërkojnë azil menjëherë kur të arrijnë në Mbretërinë e Bashkuar. Sidoqoftë, mund të ketë shumë arsye të ndryshme pse njerëzit nuk bëjnë ose nuk mund të kërkojnë azil menjëherë. Nëse nuk keni kërkuar azil menjëherë, duhet të jepni arsyet tuaja.

Është e rëndësishme të merrni një avokat për t'ju ndihmuar gjatë procesit të azilit, por mos harroni se nëse vononi të kërkonit azil, ekziston rreziku që Home Office mund të mendojë se nuk keni nevojë për mbrojtje, ose mund t'ju japin një afat më të shkurtër largimi. Për të regjistruar kërkesën tuaj, telefononi Home Office në 0300 123 4193. Ata do ju bëjnë pyetje të thjeshta për judhe familjen tuaj. Ata nuk do të pyesin pse po kërkonit azil. Ata gjithashtu do të kërkojnë një adresë ku mund t'ju dërgojnë një letër për një intervistë në Njësinë e Shqyrtimit të Azilit (Asylum Screening Unit), Lunar House, 40 Wellesley Road, Croydon CR9 2BY.

Nëse jeni i varfër ose i pastrehë, ju mund të shkoni menjëherë në Njësinë e Shqyrtimit të Azilit. Nuk keni nevojë të telefononi Home Office më parë.

## Intervista e shqyrtimit

Intervista e parë nga dy intervistat që do zhvilloni me Home Office quhet intervista e shqyrtimit. Në intervistën tuaj të shqyrtimit, Home Office do të bëjë pyetje për të përcaktuar se kush jeni dhe si keni arritur në Mbretërinë e Bashkuar. Ata gjithashtu do t'ju kërkojnë të përshkruani shkurtimisht arsyen ose arsyet pse po kërkonit azil.

Ata do ju marrin shenjat e gishtave dhe do ju bëjnë një foto. Pastaj ata do t'ju japin një kartë ose letra të tjera që konfirmojnë të dhënat tuaja personale dhe se ju keni kërkuar azil. Home Office do të kontrollojë arkivat e tyre për të parë nëse keni qëndruar më parë në Mbretërinë e Bashkuar.

Home Office do t'ju ofrojë një përkthyes falas, normalisht përmes celularit. Është e rëndësishme që ju dhe përkthyesi të kuptoni mirë njëri-tjetrin.

Mund të qëndroni në Njësinë e Shqyrtimit për disa orë. Home Office pastaj do të vendosë nëse duhet t'ju ndalojë ose lirojë gjatë procesit të kërkesës suaj. Nuk ka gjasa që të ndaloheni në Njësinë e Shqyrtimit.

Gjatë intervistës suaj të shqyrtimit, Home Office gjithashtu duhet të pyesë nëse dëshironi që intervista e azilit ose "thelbësore" të zhvillohet nga një burrë apo një grua dhe nëse do të keni nevojë për një përkthyes. Ju lutemi të merrni në konsideratë nëse e keni më të lehtë ta diskutoni historinë tuaj para një burri apo një gruaje dhe sigurohuni t'ia thoni Home Office preferencën tuaj, nëse e keni një të tillë. Intervista juaj e azilit është intervista e dytë që do të zhvilloni me Home Office ku do të flisni në detaje përkërkesën tuaj të azilit (shikoni më poshtë).

## **Intervista e azilit**

Pas intervistës suaj të shqyrtimit, do të keni intervistën e azilit. Gjatë kësaj interviste Home Office do ju pyesë në lidhje me detajet e kërkesës suaj. Disa njerëz nuk presin gjatë për intervisten e azilit dhe disa të tjerë presin për muaj të tërë. Këto intervista mund të zgjasin disa orë. Nëse keni nevojë për një përkthyes, sigurohuni që t'i tregoni Home Office paraprakisht dhe ata do ta marrin një të tillë falas.

Në fillim të intervistës, Home Office do ju pyesë nëse ndiheni mirë për t'u intervistuar, nëse keni ndonjë problem shëndetësor dhe nëse ju dhe përkthyesi e kuptoni njëri-tjetrin.

Home Office gjithashtu do ju pyesë nëse dëshironi të dorëzoni ndonjë provë. Ju duhet të përktheni çdo provë nga gjuhë të tjera në anglisht para se t'ia dorëzoni Home Office. Ju duhet t'ia tregoni provat tuaja avokatit përpara se t'i dorëzoni ato te Home Office. Avokati juaj mund t'ju këshillojë që të dërgoni provat tuaja menjëherë pas intervistës. Mos harroni të mbani një kopje të çdo prove që jepni.

Intervistuesi i Home Office do ju pyesë në lidhje me prejardhjen tuaj familjare dhe sociale. Intervistuesi gjithashtu do t'ju kërkojë të konfirmoni se kërkesa juaj bazohet në orientimin seksual ose identitetin gjinor. Intervistuesi duhet t'ju pyesë se si dëshironi t'ju drejtohet, për shembull se çfarë emri dëshironi të përdorni dhe cilat fjalë dëshironi t'i përdorni për të përshkruar orientimin tuaj seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat e gjinisë. Ata do t'ju pyesin se nga çfarë keni frikë në vendin tuaj të lindjes. Ata do t'ju bëjnë pyetje se si keni arritur të kuptoni orientimin tuaj seksual ose identitetin gjinor. Nëse keni kërkuar azil në bazë të karakteristikave të gjinisë suaj, d.m.th. sepse jeni interseksual, mund t'ju bëhen pyetje se si dhe kur u ndërgjegjësuat se karakteristikat e gjinisë tuaj ndryshonin nga ato që kanë zakonisht burrat dhe gratë. Këto janë pyetje në lidhje me historinë tuaj personale. Ata do ju pyesin se si mendoni dhe ndiheni për veten tuaj. Ata do t'ju kërkojnë të përshkruani gjithçka që mund t'ju ketë ndodhur në vendlindjen tuaj ose nëse është e rëndësishme, për partnerët e mëparshëm ose aktualë. Home Office nuk duhet t'ju kërkojë të përshkruani akte seksuale. Pyetjet do të ndryshojnë në varësi të rrethanave të çështjes tuaj.

Në fund të intervistës, do të keni mundësinë të jepni informacione shtesë. Ju gjithashtu do të pyeteni nëse keni ndonjë arsye tjetër për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar përveç atyre që diskutohen në intervistë.

Nëse keni nevojë për pushim gjatë intervistës tuaj, mund ta kërkonit. Duhet të tregoni nëse nuk kuptoni pyetjen. Nëse nuk mbani mend një datë ose detaje të tjera, është

më mirë ta thoni këtë në vend që të supozoni, në mënyrë që të shmangni rrezikun e bërjes së gabimeve që mund të bëjnë që Home Office të mendojë se nuk po thoni të vërtetën (e njohur si 'dëmtim i besueshmërisë tuaj').

Home Office zakonisht regjistron audion (vetëm zërin) e intervistave, por mund të siguroheni që ata ta bëjnë këtë duke ia kërkuar paraprakisht. Përpara se të dilni nga dhoma e intervistimit zakonisht ju jepet një kopje me shkrim e intervistës dhe një regjistrim në USB, nëse jeni intervistuar në prezencë fizike. Përndryshe, mund t'ju dërgohet me postë ose t'i vihet në dispozicion elektronikisht avokatit tuaj.

Gjatë intervistës tuaj, mund t'ju kërkohet të plotësoni një formular në të cilën ju i jepni leje ose "miratim" Home Office për të kërkuar të dhënat tuaja mjekësore nga mjekët tuaj. Ju nuk keni pse të jepni miratimin tuaj për këtë nëse nuk dëshironi. Refuzimi juaj nuk duhet të ndikojë në vendimin mbi aplikimin tuaj. Është më mirë të kërkonit këshillat e avokatit tuaj përpara se të nënshkruani formularin e miratimit.

## **Prova**

Provë konsiderohet çdo gjë që ju i dorëzoni Home Office për të mbështetur kërkesën tuaj, duke përfshirë atë që ju thoni. Regjistrimet e intervistës , deklaratat, dokumentat, letrat, raportet, deklaratat nga dëshmitarë të tjerë janë të gjitha prova.

Ju duhet të shpjegoni me detaje pse keni frikë se do të përndiqeni në vendlindjen tuaj. Shumë refuzime të kërkesave për azil të LGBTQI nga Home Office jepen sepse ato nuk besojnë se aplikantët janë lezbike, gej, biseksual, transgjitorë, homoseksual ose interseksual. Prandaj është e rëndësishme të përgatiteni të flisni mbi eksperiencën tuaj në lidhje me orientimin tuaj seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat e gjinisë. Kjo nuk do të thotë të flisni për gjininë, por se si ju jeni bërë ai/ajo që jeni si person. Ju duhet t'i përktheni në mënyrë profesionale provat me shkrim, nga gjuhë të tjera në anglisht.

Kategoritë kryesore të provave i gjeni si më poshtë, por mund të ketë edhe të tjera gjithashtu.

### **Deklarata juaj personale**

Deklarata juaj duhet të përshkruajë eksperiencat tuaja si një person LGBTQI+. Deklarata juaj duhet gjithashtu të japë detaje të ndonjë përndjekjeje që mund të keni vuajtur në të kaluarën. Mund të përfshijë përshkrime të ndonjë lidhje që mund të keni pasur. Nëse është e nevojshme mund të shkruani një shpjegim se pse nuk keni bërë kërkesë për azil më herët. Ju do ju duhet gjithashtu të shpjegoni pse keni frikë të ktheheni në shtetin tuaj dhe pse mendoni që mund të përndiqeni.

Deklarata juaj është prova juaj dhe avokati duhet t'ju ndihmojë ta përgatisni atë. Zakonisht ju duhet ta filloni me një përshkrim të familjes, edukimit dhe punësimit që mund të keni pasur në vendlindjen tuaj ose diku tjetër. Duhet të paraqisni disa të dhëna të rrugëtimit tuaj në MB.

Ju duhet të shpjegoni eksperiencat ose incidentet që kanë lidhje me çështjen tuaj. Shpjegojini ato sipas renditjes dhe si përfundim shkruani arsyet pse jeni larguar nga shteti juaj. Nëse ju kanë përndjekur në të kaluarën, ose ja keni dalë t'i shpëtoni persekutimit, duhet ta përshkruani atë.

Në fund duhet të shpjegoni pse keni frikë të ktheheni mrapsht dhe nga kush ose çfarë keni frikë.

### **Deklaratat e dëshmitarit ose letrat e mbështetjes**

Deklaratat e dëshmitarit ose letrat nga shokët, familjarët, partnerët aktual ose të mëparshëm mund të mbështesin atë që ju thoni mbi orientimin tuaj seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore ose karakteristikat e gjinisë dhe, nëse nevojitet, çdo gjë që ju ka ndodhur. Jo çdokush do ketë ose do i nevojiten deklarata të tilla.

Deklaratat e dëshmitarit ose letrat duhet të firmosen dhe të datohen. Dëshmitari duhet të japë emër mbiemër dhe adresën dhe të bashkangjisin

një kopje të dokumentit të tyre të identifikimit. Ata duhet të komentojnë mbi atë që ato dinë me të vërtetë dhe jo të spekulojnë mbi rreziqet që mund t'i kanosen nëse kthehen në vendlindjen e tyre. Nëse një dëshmitar dërgon një letër nga jashtë, siguroju që do e ruash zarfin.

### **Raportet mjekësore**

Nëse, për shembull, ju kanë sulmuar në vendlindjen tuaj ose vuani nga ndonjë problem shëndetësor, do ishte e rëndësishme të merrnit ndonjë raport nga doktori ose nga spitali ku jeni trajtuar.

### **Informacion për shtetin**

Informacioni i cili tregon situatën në vendlindjen tuaj për njerëzit LGBTQI+, si reportet mbi të drejtat e njeriut dhe artikujt e shtypit, mund të jenë të dobishme për të treguar se ka rrezik dëmtimi. Home Office duhet të ketë qasje në informacione mbi atë çfarë po ndodh në çdo shtet dhe ka [Politikat e Shtetit dhe Informacione](#) mbi shumë shtete. Home Office do të analizojë informacionin mbi shtetin dhe do vendosë nëse ata mendojnë se situata në shtetin tuaj nënkupton se atje ju kanoset një rrezik real dëmtimi të cilit ju i frikësoheni. Gjithsesi, nëse ju dorëzoni prova që mbështesin kërkesën tuaj se njerëzit LGBTQI+ përndiqen në shtetin tuaj, atëherë kjo do jetë ndihmë për çështjen tuaj.

## **Rezultate të mundshme**

Home Office do të marrë një vendim për kërkesën tuaj në bazë të intervistave dhe provave tuaja. Kjo mund të zgjasë disa muaj ose edhe më shumë. Çdo vonesë në marrjen e vendimit për aplikimin tuaj nuk ka gjasa të ketë lidhje me faktin nëse kërkesa juaj ka pasur sukses apo jo.

Ekzistojnë gjashtë vendime të mundshme ose "rezultate".

### **Rezultati 1: jepet statusi i refugjatit për 5 vite**

Nëse ju merrni statusin e refugjatit të "Grupit 1", do keni mundësi të punoni, të studioni dhe të aplikoni për ndihma sociale në MB njëjloj si një shtetas i MB.

Në përfundim të pesë viteve, ju mund të aplikoni për një leje të pacaktuar qëndrimi nëse ende rrezikoheni të përndiqeni. Ju duhet të aplikoni para se të skadojë leja juaj e qëndrimit.

## **Rezultati 2: jepet mbrojtje humanitare për 5 vite**

Nëse e keni kontaktuar fillimisht Home Office për të kërkuar një intervistë shqyrtuese më ose pas datës 28 qershor 2022, atëherë do të konsideroheni në statusin e refugjatit të "Grupit 2". Nëse Home Office vendos se nuk keni kërkuar azil në kohën kur duhej ta bënit, ose nëse jeni ndaluar në një shtet tjetër gjatë rrugës për në Mbretërinë e Bashkuar, ku konsiderohet se do të kishit mundur të kërkonit azil, atëherë mund të konsideroheni refugjat i "Grupit 2". Nëse u jepet statusi i refugjatit të "Grupit 2", do të keni të drejtën të punoni dhe të studioni në Mbretërinë e Bashkuar njëjtë me një shtetas të Mbretërisë së Bashkuar. Gjithashtu, mund të keni të drejtën të kërkonit përfitime.

Me mbarimin e periudhës 2,5 vjeçare, mund të aplikoni për ta zgjatur lejen tuaj për 2,5 vite të tjera nëse rrezikoheni ende nga përndjekja, dhe pas 10 vitesh për leje qëndrimi me afat të përhershëm. Ju duhet të aplikoni para se leja e qëndrimit si refugjat të ketë skaduar.

## **Rezultati 3: jepet mbrojtje humanitare për 2,5 vite**

Kjo është njëlloj si statusi i refugjatit. Aplikohet rrallë ndaj njerëzve të LGBTQI+ që bëjnë kërkesë për azil.

---

*Lexoni mbi ndryshimin midis statusit të refugjatit dhe mbrojtjes humanitare në [manualin e të drejtës së qëndrimit](#).*

---

## **Rezultati 4: jepet një leje tjetër qëndrimi**

Home Office mund t'ju japë "leje diskrecionale" të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar ose leje "jashtë rregullave" për një kohë të kufizuar (zakonisht për dy vjet e gjysmë). Kjo është e rrallë, por mund të jetë e përshtatshme, për shembull, nëse jeni në një lidhje me një qytetar britanik dhe ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme se pse nuk mund të ktheheni në vendin tuaj për të aplikuar për vizë për t'u bashkuar me partnerin tuaj. Ju gjithashtu mund t'ju jepet leja diskrecionale për arsye të tjera.

## **Rezultati 5: refuzohet – me të drejtë apelimi në MB**

Nëse Home Office ka refuzuar aplikimin tuaj, ju do keni të drejtën e apelimit normalisht. Shiko [‘Apelimet’](#) për më shumë informacion.

## **Rezultati 6: refuzohet – pa të drejtë apelimi**

Home Office ndonjëherë "shpall" pretendimet për azil si "qartësisht të pabaza". Kjo do të thotë se ata besojnë se kërkesa për azil nuk do të jetë e suksesshme dhe nuk



do të ketë të drejtë apelimi. Kjo mund të ndodhë nëse Home Office beson se vendlindja është e sigurt. Në raste jashtëzakonisht të rralla ndodh që Home Office të shpallë si jashtëzakonisht të pabesueshëm që një person është LGBTQI +. Mund të aplikoni për shqyrtim gjyqësor me ndihmën e një [avokati](#).

Kur bëhet një kërkesë e re (shihni më poshtë), Home Office mohon të drejtat e apelimit kundër refuzimit të azilit sepse ka pasur një apelim të mëparshëm ose mundësi për të shpjeguar kërkesën e azilit. Mund të aplikoni për një shqyrtim gjyqësor me ndihmën e një [avokati](#).

---

*Lexoni më shumë mbi shqyrtimet gjyqësore në [manualin e të drejtës së qëndrimit](#).*

---

## Apelimet

Nëse Home Office refuzon kërkesën tuaj, ju normalisht do të keni të drejtë apelimi. Ju duhet ta dërgoni formularin tuaj të apelit në Gjykatën e Shkallës së Parë (Dhoma e Emigracionit dhe Azilit) brenda 14 ditëve nga data e marrjes së letrës së refuzimit.

Apelimi juaj do të vendoset nga një gjykatës i Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila është një gjykatë e ligjit. Gjykatësi është i pavarur nga Home Office. Ju duhet të përgatitni çështjen tuaj duke iu përgjigjur arsyeve pse Home Office refuzoi kërkesën tuaj.

Ju duhet të prisni të merrni pjesë në gjykatë dhe "të jepni prova" duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me çështjen tuaj nga një përfaqësues i Home Office dhe gjykatësi. Çdo dëshmitar që mund të keni duhet gjithashtu të marrë pjesë. Ju do të jeni 'apeluesi' dhe Home Office do të jetë 'i padituri'.

---

*Lexoni më shumë mbi apelimet në [Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Lartë në manualin e të drejtës së qëndrimit ose në këtë video nga Consonant. Ju mund të gjeni më shumë informacion mbi apelimet në \[website-in e qeverisë\]\(#\).](#)*

---

### Konfidencialiteti në apeline

Apelimet në gjykatë ose gjykata të tjera në MB janë publike dhe çdo anëtar i publikut mund të marrë pjesë. Apelimi juaj do të dëgjohet nga një gjykatës që do të dëgjojë edhe apeline të tjera në të njëjtën ditë, dhe njerëz të tjerë mund të dëgjojnë çështjen tuaj.

Përcaktimi i çdo apelimi (vendim i shkruar që përcakton arsyet e detajuara) është një dokument publik që përmban emrat e apeluesve dhe dëshmitarëve. Ndosht rrallë që vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të bëhen publike, por vendimet e Gjykatës së Lartë zakonisht publikohen.

Nëse nuk dëshironi që emri juaj të bëhet publik, duhet t'i thoni gjykatës. Ju duhet të pyni në lidhje me këtë pjesë kur dërgoni formularin e apelit në gjykatë.

Ka dy gjëra që mund t'i kërkontë gjykatës të bëjë:

1. Të bëhet apelim anonim duke zëvendësuar emrin tuaj me inicialet ose, nëse ka arsye të fortë, të heqë të gjithë emrat nga vendimi.

Emrat do të mbesin në kopjet e vendimit që do ju dërgohen ju dhe Home Office, por emrat nuk do jenë në kopjet publike ose në listën e çështjeve të vendosur në mur jashtë dhomës së gjyqit.

2. Nëse ka arsye të fortë, mbani seancën dëgjimore private dhe mos lejoni që të futet askush brenda.

Gjykata duhet t'ju tregojë me shkrim, përpara seancës, nëse janë dakort me kërkesat tuaja. Ditën e seancës, përpara se të fillojë, duhet të siguroheni që stafi i gjykatës është në dijeni që keni kërkuar një seancë private ose anonime.

## **Rezultatet e apelimit**

Ka dy rezultate të mundshme nga Gjykata e Shkallës së Parë.

### **Rezultati 1: apelimi pranohet**

Kjo do të thotë që keni fituar. Home Office duhet t'ju japë statusin e refugjatit ose mbrojtje humanitare, ose një lloj tjetër leje qëndrimi nëse fitoni apelimin tuaj mbi një bazë tjetër, p.sh. jeta juaj private dhe familjare në MB.

Sidoqoftë, Home Office ka 14 ditë për të aplikuar për leje për të apeluar kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nëse ata besojnë se gjykatësi bëri një "gabim ligji". Nëse Home Office i jepet leja për të apeluar, çështja juaj do të dërgohet në Gjykatën e Lartë.

## **Rezultati 2: apelimi refuzohet**

Kjo do të thotë që keni humbur.

### **Aplikimi për leje për të apeluar në Gjykatën e Lartë**

Ju mund të aplikoni për leje për të apeluar në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nëse besoni se gjykatësi ka bërë një "gabim ligji". "Një gabim ligji" do të thotë që gjykatësi bëri një gabim në mënyrën se si ai zbatoi ligjin ose i konsideroi provat dhe nëse nuk do e kishin bërë atë gabim, ata do e lejonin apelimin tuaj.

Ju duhet ta bëni kërkesën me shkrim jo më vonë se 14 ditë pasi ju është dërguar vendimi. Avokati juaj do t'ju këshillojë nëse një aplikim për leje apelimi mund të ishte i suksesshëm. Ju duhet ta dërgoni aplikimin për leje apelimi në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Nëse Gjykata e Shkallës së Parë refuzon lejen për apelim, ju mund të aplikoni direkt në Gjykatën e Lartë. Nëse Gjykata e Lartë refuzon lejen gjithashtu, ju mund të aplikoni për një shqyrtim gjyqësor në rrethana shumë të kufizuara me ndihmën e një [avokati](#).

### **Seanca dëgjimore në Gjykatën e Lartë**

Nëse Gjykata e Shkallës së Parë ose e Lartë ju lejon të apeloni, do të zhvillohet një seancë dëgjimore në Gjykatën e Lartë.

Në seancë, Gjykata e Lartë si fillim do të vendosë nëse Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë një gabim ligji. Nëse Gjykata e Lartë zbulon se ka pasur një gabim, ata do të bëjnë një nga dy gjërat:

1. Ata do e dërgojnë çështjen mrapst te Gjykata e Shkallës së Parë për tu shqyrtuar sërish nga një gjykatës tjetër; ose
2. Ata do të rimarrin vendimin vetë. Nëse Gjykata e Lartë e rimerr vendimin, ajo zakonisht do bëhet pas një seance tjetër. Nëse Gjykata e Lartë e rimerr vendimin, ata mund ta pranojnë apelimin ose ta refuzojnë atë.

Përndryshe, Gjykata e Lartë mund të zbulojë se nuk ka pasur ndonjë gabim ligjor në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të refuzojë apelimin tuaj.

Vendimet e Gjykatës së Lartë mund të apelojnë në Gjykatën e Apelit, por kjo është e ndërlikuar dhe do t'ju duhet një avokat për t'ju ndihmuar.

## Kërkesë e re

Nëse apelimi juaj është refuzuar dhe ju nuk mund të apeloni më tej, mund të jetë e mundur të bëni një "kërkesë të re" për azil, por është një proces i ndërlikuar.

Ju mund të bëni një kërkesë të re, ose "aplikim të mëtejshëm", nëse mund të merrni prova të reja ose nëse ka ndonjë ndryshim në situatën e njerëzve LGBTQI + në vendlindjen tuaj. Ju duhet të mbyllni një takim për të marrë pjesë në Further Submissions Unit (Njësinë e Aplikimeve të Mëtejshme) në Liverpool për të paraqitur provat tuaja të reja. Në disa rrethana, nuk pritet që ju të shkoni në Liverpool, p.sh. nëse jeni i arrestuar ose nuk mund të udhëtoni për shkak të një problemi mjekësor.

---

*Ju mund të lexoni për procesin e kërkesës së re në [website-in e qeverisë](#).*

---

## Gjetja e një avokati

Për të gjetur një avokat, ju mund të kontaktoni me ato që listohen në [website-in e Rainbow Migration](#), ku ka avokatë që mund t'i paguani ju dhe të tjerë që janë të ndihmës ligjore.

Nëse nuk keni mjaftueshëm para për të paguar një avokat, ju mund të merrni avokat të ndihmës ligjore. Këto avokatë mund të jenë shumë të mirë sepse ata mund të kenë shumë eksperiencë në çështjet e azilit dhe kanë kaluar provimin e specialistit.

Ndihma ligjore do të paguajë:

- avokatin të përgatisë kërkesën tuaj për azil
- një përkthyes profesional që do marrë pjesë në takimet me avokatin
- përkthimin e provave
- raportet e ekspertëve mjekësore ose të shtetit në qoftë se është e nevojshme
- avokatin tuaj të përgatisë apelimin
- avokatin tuaj ose një avokat tjetër që t'ju përfaqësojë në seancën dëgjimore

Ndihma ligjore zakonisht nuk mund të paguajë që një avokat të telefonojë Home Office për të regjistruar një kërkesë azili për llogari tuaj, ose të marrë pjesë në intervistën tuaj të azilit nëse nuk jeni në kamp. Nuk mund të paguajë për apeline që nuk ka gjasa të jenë të suksesshme.

Ndihma ligjore do të lejojë ndryshimin e avokatit vetëm nëse ekziston një arsye shumë e fortë.

Nëse jeni ndaluar nga Home Office dhe keni nevojë për një avokat të ndihmës ligjore, kërkoni Welfare Office (Zyrës së Mirëqenies) t'ju regjistrojë për ndihmë ligjore.

Sigurohuni që të punoni fort me avokatin tuaj për të përgatitur çështjen. Bëni pyetje nëse mendoni se duhet të bëhet më shumë. Nëse shqetësoheni për punën e bërë për çështjen tuaj, ne mund të jemi në gjendje t'ju ndihmojmë, ju lutemi [na kontaktoni](#).

Nuk ka mjaftueshëm avokatë të ndihmës ligjore për të gjithë ata që kanë nevojë për një të tillë. UKLGIG ndonjëherë mund të ndihmojë njerëzit që nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë vetë një avokat.

---

*Kontrolloni nëse mund të [merrni ndihmë ligjore](#) dhe shikoni [avokatët e ndihmës ligjore](#) në website-in e Agjencisë së Ndhmës Ligjore.*

---

## Më shumë informacion

- [Lista e avokatëve të Rainbow Migration](#)
- [Kontrolloni website-in e Agjencisë së Ndhmës Ligjore nëse mund të merrni ndihmë ligjore](#)
- [Informacion nga qeveria për njerëzit që kërkojnë azil](#)
- [Manualin e të drejtës së qëndrimit: udhëzim për emigracionin në MB dhe sistemin e azilit](#)